

ÇFARË ËSHTË NJË PLAN INVESTIMI?

Plani i investimit është një skemë investimi në një nga fondet e investimit të administruar nga Raiffeisen Invest sh.a.

Njëkohësisht mënyrë kursimi dhe investimi!

Nëpërmjet një plani investimi, ju investoni:

- në fondin e investimit që ju përshtatet (sipas qëllimit/kohëzgjatjes së investimit dhe tolerancës ndaj rrezikut)
 - ▶ Raiffeisen Prestigj (në Lekë)
 - ▶ Raiffeisen Vizion (në Lekë)
 - ▶ Raiffeisen Invest Euro (në Euro)
- në mënyrë të rregullt (pagesa periodike mujore ose tremujore)
- me shuma të vogla, bazuar në mundësinë tuaj financiare
- për një periudhë kohore të paracaktuar

Plani i investimit ka karakteristikat e fondit të përzgjedhur: të njëjtën politikë investimi, performancë, luhatshmëri dhe të njëjtat reziqe e tarifa.

KUR DUHET FILLUAR NJË PLAN INVESTIMI?

Sa më shpejt, aq më mirë!

Sa më herët të filloni të kurseni e investoni nëpërmjet një plani investimi, aq më pak kontribut mujor do të jetë i nevojshëm për të arritur qëllimin tuaj.

Shembull:

Ju doni t'i dhuronit fëmijës suaj 1,000,000 Lekë (për të blerë një makinë të vogël) kur të mbushë 18 vjeç. Sa duhet të kurseni e investoni për të arritur këtë?

Mosha e fëmijës kur fillon plani i investimit	Kohëzgjatja (në vite)	Kontributi mujor
0 vjeç	18 vjet	3,500 Lekë
6 vjeç	12 vjet	5,800 Lekë
8 vjeç	10 vjet	7,150 Lekë
10 vjeç	8 vjet	9,250 Lekë
13 vjeç	5 vjet	15,450 Lekë

Shënim: Përlllogaritja supozon investimin në fond investimi në Lekë ku kthimi neto nga investimi është 3% gjatë të gjithë periudhës së investimit.

PËRSE NEVOJITET NJË PLAN INVESTIMI?

- ▶ Alternativë e mirë për të arritur objektiva të ndryshme gjatë jetës
- ▶ Mundësi investimi në shuma të vogla
- ▶ Komoditet në kryerjen e pagesave të cilat janë automatike
- ▶ Fleksibilitet: ju zgjidhni fondin e investimit që ju përshtatet,

vlerën e investimit, frekuencën e tij (mujore ose tre-mujore), datën e ekzekutimit të pagesës periodike dhe kohëzgjatjen e investimit. Pagesa periodike mund të pezullohet përkohësisht ose plotësisht dhe vlera e saj të ndryshojë në çdo kohë, pa asnjë penalitet.

- ▶ Akses në çdo kohë në fondet tuaja: kërkesat për shlyerje procesohen brenda 7 ditëve nga dita e kërkesës. Tarifa e daljes do të aplikohet vetëm në rastin kur plani i investimit orientohet drejt një fondi investimi me tarifë daljeje sipas kushteve të këtij të fundit.
- ▶ Investimi afatgjatë reduktion efektet negative të luhatjeve afatshkurtra në tregjet financiare

Objektiva afatshkurtër

- Një udhëtim
- Pushime familjare
- Makinë e re

Objektiva afatmesëm dhe afatgjatë

- Mobilim i shtëpisë
- Edukimi i fëmijëve
- Mundësia për të ushtruar pasione të ndryshme
- Hapja e një biznesi

SI TË FILLONI NJË PLAN INVESTIMI?

Pranë çdo dege të Raiffeisen Bank, komunikoni me bankierin dhe përcaktoni:

- ✓ Qëllimin e investimit
- ✓ Fondin e investimit në të cilin do të investoni
- ✓ Vlerën e investimit
- ✓ Frekuencën e investimit (mujore ose tre-mujore)

Nënshkruani formën e autorizimit për pagesa periodike!

*Informacion i rëndësishëm

Kuotat në një Fond Investimi nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave dhe investimi në fonde nuk është i garantuar. Fondet e investimit nuk bazohen në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të asetëve, dhe rreziku i humbjes së principalit përballohet nga investitori. Të gjithë shembujt/përlllogaritjet numerike, janë përdorur për qëllime ilustrative nga analiza e të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët si garanci për të ardhmen.

Investitorët e mundshëm janë të ftuar të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit/eve ku janë të interesuar të investojnë. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen INVEST sh.a., në web site www.raiffeisen-invest.al, ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.